



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KORÇË

RELACION

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR 153 DATË 07.12.2023 PËR “NIVELIN E TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE, ADMINISTRIMIN E TYRE NË BASHKINË E KORÇËS SI DHE PENALITETET PËR SHKELJET APO KUNDËRVAJTJET ADMINISTRATIVE PËR VITIN 2024”

Mbështetur në Ligjin 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjin 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, propozojmë të bëhet një ndryshim në Vendimin e Këshillit të Bashkisë Korçë nr. 153 datë 07.12.2023 “Për nivelin e taksave dhe tarifave vendore, administrimin e tyre në Bashkinë e Korçës si dhe penalitetet për shkeljet apo kundërvajtjet administrative për vitin 2024” si më poshtë:


- Propozim për ndryshimin e mënyrës dhe afatit të pagesës së tokës bujqësore në pronësi, posedim apo përdorim të taksapaguesve familjarë si dhe të tarifave të shërbimit dhe mirëmbajtjes të sistemit kullues dhe shërbimit dhe mirëmbajtjes të rrugëve të parcelave.

Në zbatim të marrëveshjes të lidhur midis Bashkisë Korçë dhe Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Korçë Sh.a të datës 25.11.2022 e cila konsistonte në mbledhjen nga agjenti tatimor SH.R.U.K.KO sh.a të taksave dhe tarifave vendore familjare si dhe mbas komunikimeve që Bashkia Korçë ka mbajtur me këtë të fundit gjatë vitit 2024 është bërë e mundur që të ndërhyet dhe të mundësohet taksimi i tokës bujqësore dhe tarifimi i tarifës vjetore e shërbimit, mirëmbajtjes së rrugëve të parcelave dhe tarifës vjetore e shërbimit dhe mirëmbajtjes të sistemit kullues në faturën e furnizimit me ujë. Ky ndryshim lehtëson të gjithë abonentët familjarë kryesisht në njësitë administrative për mënyrën e pagesës duke ju dhënë mundësinë për pagesë të shtrirë në kohë për detyrimet vjetore ashtu dhe ekzekutivin e Bashkisë për identifikim më të saktë të taksapaguesve, përditësimin të të dhënave si dhe në rritjen e arkëtimeve nga këto taksa dhe tarifa. Ky ndryshim i propozuar do të prekë vetëm ato familje të cilat kanë një kontratë të shërbimit të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve, me SH.R.U.K.KO sh.a. Për të gjitha familjet e tjera të cilat nuk kanë një kontratë të shërbimit të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve me SH.R.U.K.KO sh.a detyrimi vjetor për taksën mbi tokën bujqësore dhe tarifën e shërbimit dhe mirëmbajtjes të sistemit kullues dhe shërbimit dhe mirëmbajtjes të rrugëve të parcelave do të paguhet pranë sporteleve të bankave të nivelit të

dytë për Njësinë administrative Korçë dhe pranë sporteve të njësive administrative për njësitë e tjera administrative brenda datës 31.12.2024

**Drejtoresia e Drejtorisë së Përgjithshme
Juridike dhe të Menaxhimit
të Burimeve Njerëzore**

Anxhela Qeramixhi (Dishnica)




Drejtorija e Taksave dhe Tarifave Vendore

Soniel Prifti



KRYETARI I BASHKISË

Sotiraq FILO





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA KORÇË
KËSHILLI BASHKIAK**

P/V E N D I M

Nr. _____ datë _____ 2024

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR 153 DATË 07.12.2023 PËR
“NIVELIN E TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE, ADMINISTRIMIN E TYRE NË
BASHKINË E KORÇËS SI DHE PENALITETET PËR SHKELJET APO
KUNDËRVAJTJET ADMINISTRATIVE PËR VITIN 2024”**

Këshilli i Bashkisë Korçë, në mbledhjen e tij të datës së sotme pasi mori në analizë relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, mbështetur në Ligjin 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar, ligjin 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, mbështetur në kompetencat që ka si dhe mbas diskutimeve të anëtareve.

KËSHILLI BASHKIAK

VENDOSI

1. Të miratojë, ndryshimin në vendimin nr 153 datë 07.12.2023 për “NIVELIN E TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE, ADMINISTRIMIN E TYRE NË BASHKINË E KORÇËS SI DHE PENALITETET PËR SHKELJET APO KUNDËRVAJTJET ADMINISTRATIVE PËR VITIN 2024” si më poshtë:

Në Kapitullin I, Taksat Vendore, 1.2/b) Taksa mbi tokën bujqësore.

Të ndryshohet dhe plotësohet:

- Detyrimi vjetor për kategorinë tokë bujqësore në pronësi, posedim apo përdorim të taksapaguesve familjarë do të shpërndahet për periudhën nga momenti i përditësimit të të dhënave – Dhjetor 2024 dhe do të paguhet së bashku me faturën mujore të shërbimit të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve, pranë sporteleve të SH.R.U.K.KO sh.a. Për të gjitha familjet e tjera të cilat nuk kanë një kontratë të shërbimit të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve me SH.R.U.K.KO sh.a detyrimi vjetor për taksën mbi tokën bujqësore do të

paguhet pranë sporteve të bankave të nivelit të dytë për Njësinë administrative Korçë dhe pranë sporteve të njësive administrative për njësitë e tjera administrative brenda datës 31.12.2024.

Në Kapitullin VI, Tarifa të institucioneve të varësisë, 6.1 Ndërmarrja e Shërbimeve Publike Korçë, Tarifa vjetore e shërbimit dhe mirëmbajtjes të rrugëve të parcelave dhe të sistemit kullues

Të shtohet:

- Detyrimi për tarifën vjetore të shërbimit dhe mirëmbajtjes të rrugëve të parcelave dhe të sistemit kullues për pronarët, poseduesit apo përdoruesit e tokave bujqësore si familjarë do të shpërndahet për periudhën nga momenti i përditësimit të të dhënave – Dhjetor 2024 dhe do të paguhet së bashku me faturën mujore të shërbimit të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve, pranë sporteve të SH.R.U.K.KO sh.a. Për të gjitha familjet e tjera të cilat nuk kanë një kontratë të shërbimit të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve me SH.R.U.K.KO sh.a detyrimi për tarifën vjetore të shërbimit dhe mirëmbajtjes të rrugëve të parcelave dhe të sistemit kullues do të paguhet pranë sporteve të bankave të nivelit të dytë për Njësinë administrative Korçë dhe pranë sporteve të njësive administrative për njësitë e tjera administrative brenda datës 31.12.2024.

2. Aplikimi i këtyre taksave dhe tarifave do të implementohet në faturën mujore të shërbimit të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve gradualisht sipas çdo fshati apo njësie administrative për çdo abonent që ka të përditësuar të dhënat në sistem

3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore.

4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes publike (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”).

Sekretari i Këshillit Bashkiak

K R Y E T A R

Eva NAÇI

Ana Verushi

Miratuar me _____ vota

Vota Pro _____

Vota Kundër _____

Vota Abstenim _____